



**REPUBLIKA E SHQIPERISË**  
**Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale**  
**Komisioneri**

Nr. 39 Prot

Tiranë, më 12/09/2011

**Lënda :** Mbi kundërvajtjen administrative të kontrolluesit **Drejtoria e Përgjithshme-UKT, “ Ujësjiellës Kanalizime” sh.a, Tiranë.**

**VENDIM**

Nr. 2 ,datë 12/09/2011

Mbështetur në Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr. 211, datë 11.09.2008 “Për zgjedhjen e komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe nr 225, datë 13.11.2008 “Për miratimin e strukturës organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale”, pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit **Drejtoria e Përgjithshme-UKT, “Ujësjiellës Kanalizime” sh.a , Tiranë ;**

**KONSTATOVA**

Sipas ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, ju keni cilësinë e Kontrolluesit, pra përgjegjësinë për përpunimin e të dhënave personale dhe si i tillë keni detyrimin të zbatoni të gjitha kërkesat e këtij ligji dhe në mënyrë të veçantë të detyrimit të parashikuar në nenin 21 të tij.

Në pikën 1 të nenit 21 të ligjit të sipërm parashikohet : “Çdo kontrollues duhet të njoftojë komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i qëllimit të përpunimit, të njoftuar më parë. Ndërsa në nenin 22 saktësohet përmbytja e të dhënave që përpunoni, të cilat duhet t’i njoftoni tek Komisioneri..

Në kuadër të investigimeve dhe mbikqyrjes, lidhur me zbatimin e kërkesave të ligjit nr.9887 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, Inspektorët e Drjetorisë së Hetim Inspektimit, pranë Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, më datë 21.04.1010, kanë realizuar pranë autoritetit tuaj një takim me objekt mbikqyrjen e zbatimit të ligjit të sipërcituar.

